

SHPREHJA E KUSHTIT NË KATEGORI TË NDRYSHME TEKSTORE TË GEGËRISHTES

Liridona MEHMETI¹

¹Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Filologjisë

²Email: mehmetiliridona93@gmail.com

Abstrakt

Në këtë punim trajtojmë format e shprehjes së kushtit në kategori të ndryshme tekstesh të dialektit të gegërishtes. Me anë të këtij punimi, paraqesim mënyrat e shprehjes së kushtit në dialektin e gegërishtes krahas gjuhës standarde. Pra, qëllimi i këtij punimi është studimi i formave të të shprehurit të kushtit, mjetet gramatikore me të cilat ndërtohet kushti dhe përdorimin e kushtores në tekste të ndryshme të gegërishtes. Gjithashtu, përgjatë këtij punimi trajtojmë kushtoren, si njëra nga mënyrat e diskutuara të foljes në gjuhën shqipe, duke marrë për bazë trajtesat e gjuhëtarëve lidhur me strukturën dhe modalitetin që shpreh në tekste e kontekste të ndryshme. Për realizimin e këtij punimi, përveç pjesës teorike paraqesim edhe rezultatet nga pjesa e hulumtimit, duke përdorur metodën cilësore dhe sasiore. Korpusi hulumtues përfshin kategori të ndryshme tekstesh të shkruara në dialektin e gegërishtes, si: artikuj të ndryshëm nga tre numra të gazetës "Rilindja" (63, 64, 65); shkrime në revistën "Jeta e Re" (2001, 2003); disa pjesë tekstesh nga përmbledhjet e krijimeve të Migjenit, N.Mjedës, Gj.Fishtës, E.Koliqi.

Fjalët çelës: *format e kushtores, kushti, gegërishtja, mjetet gramatikore, tekstet.*

The expression of the condition in different textual categories of the gege dialect

Abstract

In this paper we deal with the forms of expressing the condition in different categories of texts of the gege dialect. Through this paper, we present the ways of expressing the condition in the gege dialect alongside the standard language. So, the purpose of this paper is to study the forms of expression of the condition, the grammatical tools with which the condition is built and the use of the condition in different texts.

Also, throughout this paper we treat the conditional, as one of the discussed modes of the verb in the Albanian language, taking as a basis the treatments of linguists regarding the structure and modality that it expresses in different texts and contexts.

For the realization of this paper, in addition to the theoretical part we also present the results from the research part, using the qualitative and quantitative method. The research corpus includes different categories of texts written in the gege dialect, such as: different articles from three issues of the newspaper "Rilindja" (63, 64, 65); articles in "Jeta e Re" magazine (2001, 2003); some parts of texts from the compilations of the creations of Migjeni, N.Mjeda, Gj.Fishta, E.Koliqi.

Key words: *conditional forms, condition, gege, grammatical tools, texts.*

1. Hyrje

Kushtorja në gjuhën shqipe është njëra prej mënyrave të diskutueshme, si nga ndërtimi formal ashtu edhe nga ana kuptimore. Kushtorja hyn në mesin e formave të shtjelluara foljore, e cila si kategori gramatikore e foljes shpreh mundësinë e realizimit të veprimit, nëse realizohet kushti nga subjekti folës.

Në gramatikat tradicionale kushtorja konsiderohet si njëra nga gjashtë mënyrat e foljes në gjuhën shqipe, krahas dëftores, lidhores, habitores, dëshirores dhe urdhërores. Ndërsa, në gramatikat bashkëkohore nuk e pranojnë si mënyrë, për shkak se nuk është e gramatikësuar.

Me këtë punim synojmë të shtjellojmë dhe të paraqesim shprehjen e kushtit në kategori të ndryshme tekstesh, të zgjedhura për këtë punim. Përgjatë këtij punimi trajtojmë kushtoren, si një mjet gramatikor për ta shprehur kushtin. Gjithashtu, paraqesim mendimet e disa studiuesve, lidhur me kushtoren; strukturën dhe modalitetin e saj.

Me anë të këtij punimi krahasojmë të shprehurit e kushtit në dialektin e gegërishtes, kundrejt gjuhës standarde. Qëllimi kryesor është që punimi të përfshijë tekste të periudhave të ndryshme, që t'i krahasojmë dallimet në shprehjen e kushtit në këto tekste. Pra, objekti i këtij punimi është të trajtojmë kushtin; mjetet gramatikore me të cilat ndërtohet dhe shpeshhtësinë e përdorimit të kushtores në tekste të ndryshme të gegërishtes.

Për realizimin e këtij punimi, përveç pjesës teorike paraqiten edhe rezultatet empirike, duke përdorur metodën cilësore dhe sasiore. Ky punim, teorikisht, është mbështetur në gramatika tradicionale dhe bashkëkohore.

Ndërkaq, korpusi hulumtues përbëhet nga tekste të kategorive të ndryshme; artikuj të ndryshëm të gazetës "Rilindja" e viteve gjashtëdhjetë ('63, '64, '65); shkrime në revistën "Jeta e Re" (2001, 2003); disa pjesë tekstesh nga përmbledhjet e krijimeve të Migjenit, N.Mjedës, Gj.Fishtës, E.Koliqit; artikuj në portalin "Rrokum", disa barcoleta dhe një dokument ligjor. Të gjitha janë të shkruara në dialektin e gegërishtes. Në fund të punimit, i paraqesim në formë tabelare të gjitha veçoritë për strukturat e kushtit në tekstet e lartpërmendura.

2. Vështrim teorik

2.1. Trajtimi i kushtores në gramatikat e gjuhës shqipe

Sipas F.Agalliut et al (2002:272), në bazë të kuptimeve modale dhe formave gramatikore përkatëse, në gjuhën shqipe dallohen gjashtë mënyra të foljes: *dëftore, habitore, lidhore, kushtore, dëshirore* dhe *urdhërore*.¹

Sipas kuptimeve modale themelore që shprehin, të gjitha këto mënyra të foljes mund të ndahen në tri grupe; në grupin e parë hyjnë mënyra dëftore dhe habitore që shprehin kryesisht modalitetin e vërtetësisë, në grupin e dytë hyjnë mënyra lidhore dhe kushtore, që shprehin modalitetin e mundësisë. Kurse dëshirore dhe urdhërore, që futen në grupin e tretë, shërbejnë për të shprehur kryesisht modalitetin e dëshirës; e para në formë urimi ose mallkimi dhe e dyta në formë urdhri a kërkese.²

Sipas F.Agalliut et al (2002:294,295), format gramatikore të kohës së tashme e të kohës së kryer të mënyrës kushtore (*do të mësoja, do të kisha mënuar*) qëndrojnë në raporte homonimie me ato të së ardhmes të së shkuarës dhe të ardhmes së përparme të mënyrës dëftore (*do të kisha*

¹Në disa gramatika përmendet edhe e ashtuquajtura *lidhore-habitore*, e cila për nga modaliteti anon nga lidhorja.

²Po aty, fq. 273.

mësuar, do të kem mësuar). Këto forma ndërtohen edhe me anë të pjesëzës *do të* ndjekura nga e pakryera e lidhore (*do të mësoja, do të vija*).

Sh.Demiraj (1988:700,703) thekson se përveç mënyrave dëftore, lidhore, habitore, urdhërore dhe dëshirore, të cilat në thelb janë mënyra të trashëguara (por natyrisht të evoluara si nga ana formale, ashtu edhe nga ana kuptimore) në traditën gramatikore të shqipes flitet edhe për një mënyrë të gjashtë, *kushtoren*. Ai format e tipit *do të punoja* dhe *do të kisha punuar* të përdorura në vlerën e mënyrës kushtore, për nga kuptimi kohor i trajton të diferencuara nga të njëjtat forma të përdorura me vlerën e së ardhmes, përkatësisht të së ardhmes së përparme dhe të së shkuarës së dëftores.

Ndërsa, K.Topalli (2010:172,173) mënyrat e foljeve të shqipes i ndan në dy grupe. Grupin e parë e përbëjnë ato që shprehin veprime objektive, reale (dëftorja dhe habitorja), kurse grupin e dytë e përbëjnë (lidhorja, urdhërorja dhe dëshirorja) që shprehin një hamendje, një dëshirë, një urdhër, duke paraqitur veprime subjektive, të supozuara e joreale. Duhet theksuar se Topalli nuk e radhit kushtoren në këto grupe, që na lë të nënkuptojmë se nuk e pranon si mënyrë foljore.

Studiuesi i gjuhësisë, E.Çabej (1986:109) thekson se mënyrat kryesore, në të cilat shfaqet folja në gjuhët e dokumentuara janë katër: dëftorja (indikativi), lidhorja (konjuktivi), dëshirorja (opativi), urdhërorja (imperativi). Po ashtu, ai përmend që ekziston edhe një mënyrë tjetër që quhet injuktivi, që do të ishte mënyra e pestë, e cila është vështirë të konsiderohet në një mënyrë të kohës së hershme indoevropiane. Mirëpo, as habitoren e as kushtoren nuk i përmend si mënyra në studimin e tij.

2.2. Mjetet strukturore për shprehjen e kushtit

Më lart përmendëm se me anë të kushtores shprehet modaliteti i mundësisë. Sipas F.Agalliut et al (2002:327), folja e përdorur në mënyrën kushtore tregon një veprim që mund të kryhej, po të realizohej kushti. Ai mund të jetë i mundshëm në të ardhmen ose i perealizueshëm. Kushti zakonisht shprehet me anë të një fjalie të varur kushtore, kallëzuesi i së cilës është një folje në të pakryerën e lidhore, ose në më së të kryerën e saj. Por, ai mund të shprehet edhe me anë të ndajfoljes *ndryshe*, të përdorur me vlerën e një fjalie kushtore mungesore, ose me anë të një togu të ndërtuar nga parafjala *me* ose *pa* dhe një emër (i shoqëruar ky ose jo me ndonjë përcaktor). Për shembull: *-Po pse çuditësh? **Të isha unë në vendin tënd**, ç`do të bëje ti? -Po të kisha ato mend që ke ti, do të rrihja. **Ndryshe, do të derdhej gjak kot më kot** edhe përfundimi do të ishte një robëri më e keqe se e para. **Pa ndihmën tënde**, s`do t`ia kisha dalë mbanë kësaj pune.*

Sipas B.Becit (2010:127), folja e përdorur në të kryerën e kushtores tregon një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, po të ishte vërtetuar në të shkuarën një kusht i dhënë, po meqë ky kusht nuk është i vërtetuar, veprimi i emërtuar nga e kryera e kushtores paraqitet si i perealizuar. Për shembull: ***Të më kishit njoftuar mua**, do të kisha ardhur menjëherë. Isha krejt i lirë.* (ardhja e folësit mbeti pa u realizuar).

Pra, foljet në kushtore tregojnë një veprim që mund të kryhej, po të realizohej një kusht i caktuar. Kushti shprehet zakonisht me anën e një pjese të nënrenditur kushtore, si dhe me ndajfoljen *ndryshe* të përdorur me vlerën e një pjese të nënrenditur kushtore. Për shembull: ***-Po të luanim më mirë**, do ta fitonim ndeshjen. **Përbindëshi kërkonte nga një vajzë që ta hante**, ndryshe do ta përmbyste e do ta digjte tërë vendin.*

Sipas F.Agalliut et al (2002:582), periudhat me fjali të varura kushtore në gjuhën shqipe janë shumë të larmishme nga ana strukturore dhe kuptimore. Mjetet kryesore për shprehjen e marrëdhënieve kushtore janë lidhëzat e lokucionet lidhëzore-kushtore, trajtat mënyrore e kohore të foljeve-kallëzues të fjalisë së varur e të fjalisë drejtuese dhe bashkëlidhja e tyre. Lidhëzat e

lokucionet lidhëzore, që shërbejnë për të shprehur kushtin janë: *në, në qoftë se, nëse, në është se, në rast se, po, po qe se, po të jetë se, po të jetë që, sikur, me kusht që, me konditë që, mjafton që, kur...*

Sipas T.Topallit (2013:19), përveç strukturave kushtore me anë të lidhëzave e lokucioneve lidhëzore, kushti mund të shprehet edhe me anë të fjalive kushtore pa lidhëza. Mungesa e lidhëzës, mjetit formal-gramatikor, nuk e pengon dallimin e kuptimit kushtor. Shumica e ndërtimeve lidhëzore, me anë të mënyrës lidhore e ruajnë kuptimin kushtor, edhe po t'u heqim lidhëzën.

F.Agalliu et al (2002:591) paraqesin funksionalisht si sinonimike me fjalitë e varura kushtore, janë edhe disa ndërtime me forma foljore të pashtjelluara si përcjellorja (duke *punuar*) dhe mohorja (*pa punuar*). Kurse, B.Rugova, L.Sejdiu (2015:174) theksojnë se kushti shprehet me forma të dëftores, të lidhores, të habitores, të dëshirores (*Në mos ardhsh, s`kemi çka bëjmë*) ose edhe me trajta të pashtjelluara, siç është paskajorja (*Me bo me t`ardhë, t`mys krejt*).

M.Çollaku (2012:73,74) paraqet se vështrimi tërësor, formalo-gramatikor, strukturor dhe funksional na bën të mendojmë se sistemi hipotetik i shqipes është tërësia e gjithë këtyre mjeteve që funksionojnë, herë vetëm dhe herë në bashkëpunim me njëri-tjetrin; duke bërë të mundur ekzistencën e tij krahas me sistemet e tjera, si: kohore, vendore, shkakore, qëllimore, kushtore. Po ashtu, në raste të tilla merr përparësi ana kuptimore ndaj asaj strukturore. Nuk mjafton për të dalluar një fjali të nënrenditur kushtore nga një ndërtim në të cilin shprehen raporte kundërie, krahasimi, përqasjeje a ffilluese.

Ndërsa, Sh. Demiraj (1988:705) format *do të punoja, do të kisha punuar* i trajton si forma të kushtores, që përdoren edhe me vlerën e së ardhmes të së shkuarës, si nga struktura, ashtu edhe nga ana kuptimore-modale të supozimit. Ai thotë se "*format do të punoj, do të punoja, do të kem punuar, do të kisha punuar, shprehin kryesisht veprime të supozuara që mund të jenë kryer në të shkuarën ose para një çasti të së shkuarës nëpër apodosa periudhash hipotetike.*"

Ndërkaq, për të kuptuar veçoritë dialektore të sistemit hipotetik në raport me gjuhën standarde, duhet të kemi parasysh këto çështje që lidhen me mjetet e shprehjes së raporteve kushtore:

-Mjetet lidhëse, kryesisht lidhëzat në variantet dialektore, trajtat fonetike, mënyra e ndërtimit të tyre;

-Korrelacioni kohor i trajtave dhe formave të foljeve kallëzues;

-Bashkimi i fjalive në periudhë ose me mënyrën lidhore, ose me formën e pashtjelluar foljore-paskajoren geqe;

-Denduria e përdorimit të mjeteve lidhëse, në dialektin gegë përdoret më shumë lidhëza kohore, si dhe paskajorja geqe, herë në vend të lidhores, herë në vend të paskajores.

Në gegërishten veriore është mjaft e përdorshme edhe një formë e kohës së shkuar të paskajores, e cila haste vetëm në një funksion sintatik të caktuar, përdoret si folje-kallëzues e një fjalie kushtore në një periudhë hipotetike: *me pa kâ^on aj/ kesh ngre vij (me pas qenë); mos me pa dit/ kiske nejt (me pasë ditë);...as me m`pa majt para duersh n(me pasë mbajtë)* (J.Gjinari, Gj. Shkurtaç, 2003:241).

3. Shprehja e kushtit në kategori të ndryshme tekstore të gegërishtes

Në këtë pjesë paraqesim pjesën hulumtuese të këtij punimi, më saktësisht, prerje tekstore si: pjesë nga publicistika; gazeta "*Rilindja*", revista letrare "*Jeta e Re*", artikuj nga portali "*Rrokum*"; pjesë letrare si: "*Mrizi i zanave*" të Gj.Fishtës, "*Juvenilia*" të N.Mjedes, "*Vargjet e lira*" të Migjenit, pjesë nga përmbledhja me tregime "*Tregtar flamujsh*" të Ernest Koliqit; pjesë nga

dokumente ligjore; "Kodi Civil" nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë dhe disa barcoleta. Të gjitha tekstet e zgjedhura janë të shkruara në gegërisht.

1. Në komunën e Gilanit po shtohet numri i shkollave tetëvjeçare, prej nga po dalin gjithnjë e më shumë filloristë, të cilët po i vazhdojnë mësimet në shkollat e mesme. Kështu, shkollat shtatëvjeçare në Malishevë dhe Kishna Pole kësaj vjeshte do të shndërrohen në shkolla të plota filllore. **Atëherë** në komunën e Gilanit do të ketë 11 shkolla tetëvjeçare **nëqoftëse** do të bahen këto të plota. Edhe mbrenda në qytet ndihet nevoja për një shkollë të tretë tetëvjeçare.

(Rilindja, 3 korrik 1963, fq.7)

Në këtë pjesë tekstore kemi vetëm një strukturë (periudhë) kushtore, e cila është ndërtuar nga lokucioni lidhëzor *nëqoftëse* dhe ndajfolja *atëherë*. Kjo paraqet kusht të hapur, për shkak se pritet të realizohet veprimi nga fjalia drejtuese, të cilës i paraprin ndajfolja *atëherë*, që në këtë rast e përforcon edhe më shumë kushtin. Kështu, kjo strukturë paraqet modalitet të pritsshmërisë, në një të ardhme të afërt.

2. Në vjetin e Ri-Rezultate edhe ma të mëdha në të gjitha lamit e veprimtaris së bashkësis sonë socialiste. Plani i ynë 7-vjeçar duhet patjetër të vehtet në harmoni me mundësit tona, po edhe me nevojat tona. Kjo gja **do të mbërrihet** vetëm **nëqoftëse** u përmbahemi në mënyrë rigoroze rregullave me investue në ndërtimin e atyne sipërmarrjeve, të cilat do të jenë rentabile dhe të cilat do të japin ma parë prodhime, veçanërisht asish për eksport.

(Rilindja, 1 janar 1964, fq.2)

Në këtë pjesë teksti kemi vetëm një fjali kushtore, e cila si mjet për shprehjen e kushtit ka lokucionin lidhëzor *nëqoftëse*, të paraprirë nga kallëzuesi (folja) *do të mbërrihet* si formë e kohës së tashme e kushtores. Po ashtu, në këtë pjesë janë përdorur edhe kallëzues në kohën e ardhme të mënyrës dëftore. Shpreh modalitet të mundësisë e pritsshmërisë dhe paraqet kusht të hapur.

3. Përpos kësaj mendohet se shkëputja e Hanës **do të shkaktonte** me siguri edhe stabilizmin e Tokës, gja që, ndërkaq nuk ka ndodhë nga që boshiti i Tokës tregon disa lëkundje, të cilat për çdo një mijë vjet janë shtatë shkallë. Por, **nëqoftëse** supozojmë se teoria e Darvinit, Vizeut dhe Kameronit asht një teori e saktë, **atëherë** banorëve të Tokës u kanoset rreziku prej Hanës.

(Rilindja, 11 shkurt 1965, fq.11)

Në këtë pjesë teksti kemi dy struktura kushtore. Struktura e parë është ndërtuar nga një kallëzues (folje) *do të shkaktonte*, që është në kohën e tashme të kushtores, ndërsa struktura e dytë me anë të lokucionit lidhëzor *nëqoftëse* dhe ndajfoljes *atëherë*, si përforcuese në marrëdhëniet kushtore. Në dy strukturat paraqitet kushti i hapur dhe shprehet modaliteti i mundësisë e supozimit.

4. **Po të mos kish qenë** i përlyer në këtë punë, ua kish sjellë pushkët dhe kish luftuar si burrat me ta. I ka takuar me vdekë si desin burrat në mbrojtje të mikut dhe nderit të konakut. Ai e ka pasur për detyrë me qëndrue... Por si të qëndrohet, o miq, me tri pushkë kundër 300 sejmeneve... **N'dashi** me vdek të tanë, po vdesim, po vdesim, unë me juve jam, iu tha, por është më mirë, më këqur e me ia gjetë një derë kësaj pune. Për të gjallit gjithmonë gjindet një derë. Do të shkoj te pasha, iu tha dhe **n'koftë** nevoja me qypa florijshtë do t'i paguaj kokat tuaja.

(Jeta e Re, 2001, fq.812)

Në këtë pjesë teskti kemi tri struktura kushtore, të cilat janë të ndërtuara me anë të lidhëzave *po*, *n`*, *n`*, bashkë me pjesëzën *mos* e foljet *kish qenë*, *dashi*, *koftë*. Struktura e parë paraqet kusht të mbyllur dhe shpreh modalitet të dëshirës. Struktura e dytë paraqet kusht të hapur dhe shpreh modalitet të mundësisë e dëshirës. Ndërsa, struktura e tretë paraqet kusht të hapur dhe shpreh modalitet të dëshirës e pritsshmërisë.

5. Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, sot i ka ba thirrje politikanëve dhe shokëve të tij që të dorëzohen në Gjykatën Speciale **në qoftë** se kundër tyne ngriten padi, por në ndërkohë nuk ka dasht me paragjykie rreth asaj se si do të vepronte ai **nëse** do ta gjente veten në situatë të njajtë.

Këto deklarata Thaçi i ka dhanë për agjencinë austriake APA, e cila konstaton se presidenti kosovar në të njëjtën kohë i ka ikë përgjigjes në pyetjen se çfarë do të bante në rast se padia do të ngritej edhe kundër tij, transmeton Klan Kosova. Presidenti po ashtu ka shtue se UÇK ka ba luftë të drejtë dhe se i ka respektue krejt të drejtat nderkombëtare. “Nëse i kemi shkel ligjet, atëherë ato nuk ishin nderkombëtare, por ligjet e Slobodan Miloshevic’it”, ka theksue Thaçi. (Rrokum, e enjte, 16 qershor 2016)

<http://www.rrokum.tv/lajme/cka-kishte-me-ba-thaci-nese-akuzohet-prej-speciales/>

Në këtë pjesë teksti kemi tri struktura kushtore. E para është ndërtuar me lokucionin lidhëzor *në qoftë se* dhe lidhëzës *nëse*. Kjo strukturë paraqet kusht të hapur dhe shpreh modalitet të mundësisë. Struktura e dytë është ndërtuar me lokucionin lidhëzor *në rast se*, që shpreh modalitet të mundësisë dhe paraqet kusht të hapur. Struktura e tretë si mjet ndërtues ka lidhëzën *nëse* dhe ndajfoljen *atëherë*. Paraqet kusht të hapur dhe shpreh modalitet vlerësues.

6. **Me folun** shqyp: *se shqyp shkolla do t`bahej*

N`dhe tonë: se i hueji ndër ne mund t`rrite

A si rrogtar i yni, ase ndo` i hera,

-Po t`ishit ai nieri i ndershëm-si zot punët

N`punë t`vet: por jo në krye të vendit...

Këtu shqyptari vetëm do t`sundonte

E i hueji, pa fjalë, do t`shtrohej ligjevet t`tija

A se ndryshe për krahit jashtë me u qitun.

(Gjergj Fishta, "Mrizi i zanave", Naim Frashëri, Tiranë, 1913, fq.85)

Në këtë pjesë tekstore kemi dy struktura kushtore. E para është ndërtuar me formë të pashtjelluar, në këtë rast paskajorja geqe *me folun*. Paraqet kusht të hapur dhe shpreh modalitet të mundësisë. Struktura e dytë është e ndërtuar nga lidhëza *po bashkë me* foljet *t`ishit*, *do t`sundonte*, *do t`shtrohej* dhe ndajfoljen e mënyrës *ndryshe*. Paraqet kusht të mbyllur dhe shpreh modalitet të mundësisë dhe dëshirës.

7. **Me e pasë dijt`** të mjerët kur rrishe

Kërkue t`kishin gëmb mbi gëmb

Me e pasë ndie njat za qi lëshoshe,

Me e pasë ndie njat vajin tand,

Kishin ardhë kudo qi t`shkoshe,

T`kishin lypun kand e kand.

Me dijtë hyjt me bisedue,

Me pasë sy qi me derdh lot

Vajin tand ju kishin prue,

T`kishin kja për jet` e mot.

(Ndre Mjedja, "Juvenilia", Dituria, Tiranë, 1999, fq.20-21)

Në këtë pjesë të tekstit kemi pesë struktura të kushtit. Të gjitha janë të ndërtuara me një formë të së shkuarës të paskajores, si veçori për gegërishten veriore. Paraqesin kusht të mbyllur dhe shprehin modalitet hipotetik-supozues.

8. **Oh, ta kishe** pishën e madhe edhe të ndezun!

Me flakën e pishës në qiellin e kësaj nate,

Ta shkrueshe kushtrimin... Ehu, burrë i tretun!

Do ta shifsha vallen tande në majë të një shpate...

(Migjeni, "Vargjet e lira", Rilindja, Prishtinë, 1990, fq.83)

Në këtë pjesë teksti kemi dy struktura kushtore. E para është ndërtuar me foljen *ta kishe* që paraqet kusht të mbyllur dhe shpreh modalitetin e pamundësisë. Struktura e dytë është e ndërtuar nga folja *do ta shifsha*, që paraqet kusht të mbyllur dhe shpreh modalitet të dëshirës.

9. *Por un tham, n`at t`emën, se padrejtësi e madhe më duket mos me qënë i ushqyem prej dheut shqiptar shi njëj qi këndon me dashuni të parrëfyeshme bukurit e atij dheut. –Kanë dalë mëç të gjithë-u idhnue Simon Rrükulli. Për me pasë të drejtë me hângër duhet me punue. –E ajo qi bân ai...teveqel, s`asht një punë. E tue u drejtue kërcnueshëm kah vajza: -E ti, në daç m`u shnjertzue...*

(Ernest Koliqi, "Tregtar flamujsh", Gjon Buzuku, Tiranë, 1935, fq. 29-31)

Në këtë pjesë tekstore kemi dy struktura kushti. E para është e ndërtuar me anë të paskajores geqe për me pasë të drejtë dhe foljes modale *duhet*. Paraqet kusht të hapur dhe shpreh modalitet të mundësisë. Struktura e dytë është ndërtuar me lidhëzën *në* e foljen *daç*, që paraqet kusht të hapur dhe shpreh modalitet të mundësisë e dëshirës.

10. *Neni 487. –Në qoftë se bashkëshorti nuk len fëmijë legjitimë, por të parëlindunë ose fëmijë natyrale, ose vëllazën ose motra, ose të palindunë të këtyne, bashkëshorti pasjetuës merr në pronësië një të tretën e trashigimit. Por në qoftë se bashkëshorti konkuron me të parëlindunë legjitimë dhe me fëmijë natyrale, mer vetëm një të katërtën e trashigimit.*

(Kodi Civil, 1929, Mbretëria Shqiptare, Ministria e Drejtesis, Tiranë, 2010, fq.188)

Në këtë pjesë teksti kemi dy struktura kushtore. Të dyja janë të ndërtuara me anë të lokucionit lidhëzor *në qoftë se*; paraqesin kushte të hapura dhe shprehin modalitete të vërtetësisë dhe mundësisë.

11. *Nji zemërngushtë (tahmaçar) kishte pas ra në ujë e donte me u mbytë, se nuk kishte pas ditur not. Qëllon njëri atypari e i thotë: -Ama dorën, bre burrë! Nji tjetër, që e kishte pas njohur këtë zemërngushtin, ia kthen këtij: -Ai nuk asht msue me dhanë, por veç me marrë e thuj: "Ha dorën!" e jo ama dorën, n`dash me e pshtue pa u mytë.*

<http://orashqiptare.blogspot.com/2013/05/anekdoda-1.html>

Në këtë tekst kemi vetëm një strukturë të kushtit, e cila është ndërtuar me lidhëzën *n`*, duke u mbështetur edhe me kallëzuesin (foljen) *n`dash*. Kjo strukturë paraqet kusht të hapur dhe shpreh modalitet hipotetik (supozues).

3.1. Interpretimi i rezultateve

Në këtë pjesë të punimit paraqesim rezultatet e shprehjes së kushtit në mënyrë tabelare, të 11 teksteve të kategorive të ndryshme, që janë përzgjedh për hulumtim të këtij punimi.

Nr. i tekstit:	Kategorizimi/tipi tekstor:	Mjetet gramatikore për shprehjen e kushtit:	Sa?
Teksti 1	joletrar/argument-koment	<i>nëqoftëse, atëherë</i>	2
Teksti 2	joletrar/argument-koment	<i>do të mbërrihet, nëqoftëse</i>	2
Teksti 3	joletrar/argument-koment	<i>do të shkaktonte, nëqoftëse</i>	2
Teksti 4	letrar/rrëfyes	<i>po të mos kish qenë, n`dashi, n`koftë</i>	3
Teksti 5	joletrar/rrëfyes	<i>në qoftë se, do të vepronte, nëse do ta gjente, do të bante, në rast se, do të ngritej, nëse</i>	8
Teksti 6	letrar/rrëfyes	<i>me folun, po t`ishit, do t`sundonte, do t`shtrohej, ndryshe</i>	5
Teksti 7	letrar/rrëfyes	<i>me pas dijt`, me e pas ndie, me dijtë hyjt, me pasë sy</i>	4

Teksti 8	letrar/rrëfytes	<i>ta kishë, do ta shifsha</i>	2
Teksti 9	letrar/rrëfytes	<i>për me pas të drejtë, duhet, në daç</i>	3
Teksti 10	joletrar/udhëzues	<i>në qoftë se</i>	1
Teksti 11	letrar/rrëfytes	<i>n`dash</i>	1

Në bazë të tabelës së mësipërme, mund të vërejmë se kushti në këto tekste është shprehur me anë të lokucioneve lidhëzore, si: *në daç, n`dash, n`dashi, n`koftë, në qoftë se, nëse, në rast se, po qe se*. Gjithashtu, kushti është shprehur me përdorimin e ndajfoljeve, si: *atëherë, ndryshe*; me anë të trajtave foljore, si: *do të mbërrihet, do të shkaktonte, do të vepronte, do ta gjente, do të bante, do të ngritej, do t`sundonte, do t`shtrohej, do ta shifsha, ta kishë, duhet*; me anë të formave të pashtjelluara foljore, si paskajorja: *me folun, me pasë sy, me dijtë hyjt*; me anë të fjalive kushtore, si: *po të mos kish qenë, nëse do ta gjente, po t`ishit, me pas dijt`, me e pas ndie, për me pas të drejtë*.

4. Përfundime

Gjatë shtjellimit të këtij punimi dhe hulumtimit të këtyre teksteve, kemi vërejtur se kushti shprehet me mjete të ndryshme leksiko-gramatikore, varësisht prej zgjedhjes dhe kategorisë së tekstit. Në tekstet joletrare, të tipit argumentues-koment, kryesisht në shkrimet publicistike (gazetë, revistë) kemi struktura të shprehjes së kushtit me anë të lokucioneve lidhëzore të specializuara *në qoftë se, në rast se, po qe se, nëse* dhe me anë të ndajfoljes kohore *atëherë*. Në tekstet letrare, të tipit rrëfytes strukturat e shprehjes së kushtit paraqiten edhe me anë të formave të pashtjelluara foljore, si paskajorja *me pas dijt`, me e pas ndie, me dijtë hyjt, me pasë sy, me folun*, që zëvendëson lidhoren e gjuhës standarde, si dhe me anë të lidhëzave *në, n`, po*, të cilat dalin edhe të bashkëlidhura me foljet, si: *n`paç, në daç, n`koftë, n`e shifsha, po të tregohej, po t`ishit, po t`mos kish qenë, ta kishë, do te bante, do te ngritej, do t`i falshin, do t`sundonte*. Gjithashtu, në këtë tip teksti, në strukturat kushtore paraqitet edhe folja modale *duhet*, e cila përveç që shpreh kusht e përforcon realizimin e kushtit.

Po ashtu, në kategorinë e teksteve letrare të tiptit rrëfytes, për shprehjen e kushtit janë përdorur edhe lidhëzat kushtore *sikur* dhe *nëse*, të cilat nuk i hasim shpesh në këta tipa tekstesh. Në këto tekste për shprehje të kushtit, është përdorur ndajfolja e mënyrës *ndryshe*, që shërben për të lidhur strukturat mungesore kushtore (eliptike). Ndërsa, në tipat e tekstit udhëzues-instruktiv (këshilla, udhëzime, ligje) të kategorizimit joletrar, strukturat kushtore paraqiten me anë të lidhëzave: *në rast që, në qoftë se* dhe foljes modale *duhet*, të cilat shprehin mundësi e domosdoshmëri, ashtu si edhe vetë natyra e këtyre teksteve.

Si përfundim, mund të themi se kushti shprehet me anë të mjeteve gramatikore, mjete kryesisht shërbyese, si *lokucionet e lidhëzat kushtore*, pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës, si *ndajfoljet e kohës dhe mënyrës*. Po ashtu, edhe me pjesë të ndryshueshme, si foljet në mënyrën *dëftore, lidhore, dëshirore* dhe me anë të formave të pashtjelluara foljore, si *paskajorja, përcjellorja e mohorja*.

Referencat

- [1]. Agalliu F. et al. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: ASHSH
- [2]. Agalliu F. et al. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe II*. Tiranë: ASHSH
- [3]. Beci B. (2010). *Gramatika e gjuhës shqipe (për të gjithë)*. EDFa, Tiranë.
- [4]. Barthes R. (1987). *Aventura semiologjike*. Prishtinë: Rilindja
- [5]. Çabej E. (1986). *Studime gjuhësore VII*. Prishtinë: Rilindja
- [6]. Çota L. (2013). *Strukturat eliptike dhe roli i komponentëve gramatikorë në përcaktimin e elipsës kontekstuale në gjuhën shqipe dhe angleze*. Punim doktrate, Tiranë: Universiteti i Tiranës
- [7]. Çollaku M. (2012). *Raportet kushtore dhe sistemi hipotetik në gjuhën shqipe*. Punim doktrate, Tiranë: Universiteti i Tiranës
- [8]. Demiraj Sh. (1988). *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*. Prishtinë: Rilindja
- [9]. Gjinari J. Shkurtaj Gj. (2003). *Dialektologjia*. Tiranë: Libri universitar
- [10]. Ismajli B. (2012). *Sa ballkanike janë mënyrat e foljeve të shqipes- Habitorja dhe kushtorja*. Prishtinë: ASHAK
- [11]. Ismajli R. (1980). *Shumësia e tekstit*. Prishtinë: Rilindja
- [12]. Memushaj R. (2005). *Shqipja standarde*. Tiranë: Toena
- [13]. Mujaj H. (2004). *Gjuhësia e tekstit*. Prishtinë: Faik Konica
- [14]. Rugova B. Sejdiu L. (2015). *Hyrje në gramatikën e tekstit të gjuhës shqipe*. Prishtinë: Trembelat
- [15]. Topalli K. (2010). *Sistemi foljor i gjuhës shqipe*. Tiranë: Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, QSA
- [16]. Topalli T. (2013). *Gramatika e gjuhës shqipe (sintaksa e fjalisë)*. Shkodër: Tekst universitar.